



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 09.07.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN “EFIÇENCA ENERGJETIKE PËRMES SEKTORIT BANKAR”, RATIFIKUAR ME LIGJIN 89/2015”

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 09.07.2018 shqyrtoi projektligjin “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “efiçenca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin 89/2015” në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin zëvendësministri i Ministrisë së Energjetikës dhe Infrastrukturës .

2.0 Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit është denoncimi i marrëveshjes së bashkëpunimit financiar 2010, “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin 89/2015, ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe kalimin e fondeve që nuk janë zbatuar në mbështetje të projektit “*Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes Fondit të Garancisë së Kredive Rurale*”.

Kuvendi me ligjin 89/2015, ka ratifikua marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Republikës Federale të Gjermanisë e cila parashikonte vënien në dispozicion të fondeve për kredi nga ana e KFW-së, për bankat shqiptare, për të promovuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Me anë të notës verbale nr.225, datë 6.9.2017, Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë sqaron se, për shkak të likuiditetit të lartë në sektorin financiar shqiptar, rezultoi që kjo nismë nuk ishte efiçente për bankat shqiptare.

Në notën verbale theksohet se në Shqipëri pengesa më e madhe për dhënien e kredive nuk ishte mungesa e mjeteve financiare, por mungesa garancive nga ana e kredimarrësve. Pikërisht këtu, Fondi i Garancisë së Kredive Rurale (RCGF) ndërhyr duke vënë në dispozicion të bankave dhe biznesit garanci si dhe duke mundësuar dhënie kredie për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Për këtë arsye palët kanë rënë dakord për ndryshimin e kushteve të përgjithshme duke realizuar promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet një instrumenti tjetër – Fondit të Garancisë së Kredive Rurale (RCGF).

Me anë të këtij projektakti synohet tërheqja nga marrëveshja, e cila vlerësohet të jetë e pazbatueshme dhe, në këtë mënyrë, t’i hapet rrugë nënshkrimit të një marrëveshjeje të re për mbështetjen e projektit “*Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes Fondit të Garancisë së Kredive Rurale*”

5.0 Diskutimet në Komision :

Deputetet në diskutimet e tyre kërkuar sqarim për mos realizimin e programit për “*Eficienca energjetike përmes sektorit bankar*” dhe faktorët që kanë ndikuar në këtë mosrealizim . Gjithashtu sqaruan pse ky fond do të kalonte sektorit të buqësisë .Nga shpjegimet e përfaqësuesve të institucioneve, deputetët u shprehën dakord për miratimin e denoncimit të marrëveshjes të ratifikuar më parë me ligjin 86/2015.

6.0 Aspekti procedural i projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për ratifikim në zbatim të nenit 81, pika 1 dhe 121 pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës.

Kjo marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë, Kreu II”Marrëveshjet Ndërkombëtare, në neni 121 i saj. Marrëveshja është hartuar, mbështetur nenin 29 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” në të cilën thuhet “

1. *Republika e Shqipërisë mund të denoncojë një marrëveshje ndërkombëtare, sipas parashikimeve të marrëveshjes dhe të këtij ligji.*
2. *Denoncimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për marrëveshjet e ratifikuara prej tij ose Këshilli i Ministrave për marrëveshjet e miratuara prej tij pas nënshkrimit apo që kanë hyrë në fuqi me nënshkrim.*
3. *Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave propozimin për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:*
 - a) *projektligjin ose projektvendimin për denoncimin e marrëveshjes;*
 - b) *projektvendimin për propozimin e projektligjit;*
 - c) *mendimet e ministrave të institucioneve të interesuara e të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, kur marrëveshja ka efekte financiare, si dhe të Ministrisë së Integrimit Europian, kur marrëveshja ka lidhje me acquis të Bashkimit Europian;*
 - ç) *relacionin shpjegues, sipas pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji, përfshirë argumentet për pranimin ose jo të propozimeve të vërejtjeve të ministrave ose institucioneve të interesuara.”*

Procedura e ndjekur për hartimin e nënshkrimit e marrëveshjes “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “efiçenca energjetike përmes sektorit bankar, ratifikuar me ligjin 89/2015 është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, nën për nen dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI

